



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 3570 Prot.

Patos, më 20/09/2024

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 4, datë 20/09/2024

PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 65 DATË 17.09.2024 PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE NË NEVOJË QË PËRFITOJNË RIKONSTRUKSION BANESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT

Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kreu VII-të të ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; VKB nr. 81 datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, dhe buxhetin e bashkisë Patos për vitin 2024“. Për vitin 2024, është miratuar programin buxhetor “Strehimi Social”, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë në listën përfundimtare të familjeve në nevojë që përfitojnë rikonstruksion banese nga sistemi pikëzimit dhe znj. Lutfije Grëmbi.

Ekipi Menaxhimit të programit:

Boreta Murati
Drejtues i Programit

Fabjola Dervishaj
Anëtar

Anisa Kripa
Anëtar

JURISTE
Nurkë Hazizaj

Grisilda Muçaj
Anëtar

Edona Beqaj
Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 35701 Prot.

Patos, më 20/09/2024

RELACION

PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 65 DATË 17.09.2024 PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE NË NEVOJË QË PËRFITOJNË RIKONSTRUKSION BANESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT

Bazuar kërkesave të paraqitura nga qytetarët për rikonstruksion banese për familjet në nevojë, komisioni i strehimit pasi shqyrtoi kërkesat e paraqitura dhe dokumentacionin përkatës bëri vlerësimin për çdo dosje, sipas vendimit të K. Bashkiak me nr. 16, datë 29.02.2024 me nr. 497/2 prot., datë 07.03.2024, dhe miratoi listës emërore të familjeve përfituese sipas VKB.nr 65 datë 17.09.2024 si dhe tabelën përmbledhëse me vlerë prej 4,710,588.7 (katër milionë e shtatëqindë e dhjetë mijë e pesëqindë e tetëdhjetë e tetë pikë shtatë) lekë.

Vlera për rikonstruksion e banesave për vitin 2024 është miratuar me vendimin K. Bashkiak nr. 81 datë 18.12.2023 në programin buxhetor "Strehimi Social", me zërin Rikonstruksioni i banesave të kushteve të papërshtatshme për familjet në nevojë", në vlerën 5,153,623 (pesë milion e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) lekë me tvsh.

Kjo vlerë është shpërndarë për rikonstruksionin e 12 (dymbëdhjetë) familjeve me preventiv të ndarë sipas kushteve të objektit përkatës. Preventivi i hartuar nga drejtoria për znj. Lutfije Grëmbi me vlerë 443,004.3 (katërqindë e dyzetë e tre mijë e katërpikë tre) lekë i shtohet tabelës përmbledhëse të VKB nr. 65 datë 17.09.2024.

Konkretisht në zërat e punimeve rikonstruksioni pjesëshëm për znj. Lutfije Grëmbi do të përfshihen këto punime; riparim çatie ekzistuese, ndërtim tavane, breza betoni she suvatime të pjesëshëm. Ky fond është parashikuar për blerje bazë materiale dhe punimet do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

Ina Sauli

Grisilda Muçaj

KOMISIONI

Gazmira Plesati

Arben Shpërdheja

Edona Beqaj



KRYETAR
Faton Duro